LIGJ
Nr.10 287, datë 10.6.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE TË EVAZIONIT FISKAL, PËR TAKSAT MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe të evazionit fiskal, për taksat mbi të ardhurat dhe kapitalin".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6607, datë 18.6.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TAKSAT MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN

Republika e Shqipërisë dhe Republika Federale e Gjermanisë,
me dëshirën për të nxitur marrëdhëniet e tyre të ndërsjella ekonomike me anë të shmangies së tatimit të dyfishtë, si dhe për të forcuar bashkëpunimin e tyre në çështje tatimore,
kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1
Personat për të cilët zbatohet marrëveshja

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për persona, të cilët janë rezidentë të një ose të dy shteteve kontraktuese.

Neni 2
Taksat për të cilat zbatohet Marrëveshja

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për taksat mbi të ardhurat dhe kapitalin, të vendosura në emër të një shteti kontraktues, një landi ose një nënndarjeje politike apo autoriteti lokal, pavarësisht nga mënyra në të cilën janë vendosur ato.

2. Do të konsiderohen taksa mbi të ardhurat dhe kapitalin të gjitha taksat e vendosura mbi të ardhurat totale, kapitalin e përgjithshëm ose elemente të të ardhurave apo kapitalit, duke përfshirë taksat mbi të ardhurat nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, taksat mbi shumat totale të pagave ose rrogave të paguara nga ndërmarrjet, si dhe taksat mbi vlerësimin e kapitalit.

3. Taksat ekzistuese për të cilat zbatohet kjo Marrëveshje janë veçanërisht:

a) në Republikën Federale të Gjermanisë:

- taksa mbi të ardhurat (Einkommensteur);
- taksa e korporatës (Korperschaftsteuer);
- taksa mbi sipërmarrje (Gewerbesteuer);
- taksa mbi kapitalin (Vermogensteuer);

përfshirë shtesat e vendosura mbi to;

- (në vijim të referuara si "taksat gjermane");

b) në Republikën e Shqipërisë:

- taksa individuale e të ardhurave;
- taksa mbi fitimet e korporatave;
- taksa bisnesit të vogël;
- taksa mbi kapitalin;

(në vijim të referuara si "taksat shqiptare").

4. Marrëveshja zbatohet gjithashtu për taksa identike ose të ngjashme në thelb, që janë vendosur pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes, si shtesa ose në vend të taksave ekzistuese. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën në lidhje me çdo ndryshim thelbësor që është bërë në ligjet e tyre përkatëse mbi tatimet.

Neni 3

Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe i përdorur në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila sipas ligjeve të saj dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin e detit, nëntokën detare dhe burimet e tyre natyrore;

b) termi "Gjermania" nënkupton Republikën Federale të Gjermanisë dhe përdorur në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës Federale të Gjermanisë, si dhe zonën e shtratit të detit, nëntokës së tij dhe shtyllës ujore mbi të që kufizohen me hapësirën detare territoriale, për sa kohë që Republika Federale e Gjermanisë mund të ushtrojë të drejta sovrane dhe juridiksion në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe legjislacionin e saj të brendshëm për qëllime të eksplorimit, shfrytëzimit, mbrojtjes dhe menaxhimit të burimeve natyrore të përpunuara dhe të papërpunuara;

c) termat "Shtet kontraktues" dhe "Shteti tjetër kontraktues" nënkuptojnë Shqipërinë ose Gjermaninë, siç e kërkon konteksti;

d) termi "person" nënkupton një person fizik, një kompani dhe çdo grup tjetër personash;

e) termi "kompani" nënkupton çdo ent ligjor që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

f) termi "ndërmarrje e një shteti kontraktues" dhe "ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues" nënkuptojnë përkatësisht një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i një shteti kontraktues ose një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i shtetit tjetër kontraktues;

g) termi "transport ndërkombëtar" nënkupton çdo transport me anije ose avion të

përdorur nga një ndërmarrje që e ka selinë e menaxhimit efektiv në një shtet kontraktues, përveçse kur anija ose avioni përdoren vetëm midis vendesh në shtetin tjetër kontraktues;

h) termi "shtetas" nënkupton:

aa) në lidhje me Gjermaninë:

- çdo shtetas gjerman në kuptimin e kushtetutës së Republikës Federale të Gjermanisë dhe çdo person juridik, ortakëri dhe shoqëri, statusi i të cilëve lind si i tillë nga ligjet në fuqi në Gjermani;

b) në lidhje me Shqipërinë:

- çdo person fizik që ka shtetësi shqiptare dhe çdo person juridik, ortakëri dhe shoqëri, statusi i të cilëve lind si i tillë nga ligjet në fuqi në Shqipëri;

i) termi "autoritet kompetent" nënkupton:

aa) në rastin e Gjermanisë, Ministrinë Federale të Financave ose agjencinë së cilës i janë deleguar kompetencat;

bb) në rastin e Shqipërisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

2. Për sa i përket zbatimit të marrëveshjes në çdo kohë nga një shtet kontraktues, çdo term i papërkufizuar në të, për sa kohë që konteksti nuk e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ka pasur atë kohë sipas ligjit të atij shteti për qëllime tatimore për të cilat zbatohet kjo marrëveshje, ku kuptimi sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij shteti ka përparësi mbi një kuptim të dhënë termit sipas ligjeve të tjera të atij shteti.

Neni 4

Rezidenti

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi "rezident i një shteti kontraktues" nënkupton çdo person, i cili sipas ligjeve të atij shteti, është i detyruar të paguajë taksat përkatëse për shkak të banesës së tij, rezidencës, vendit të menaxhimit ose çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe përfshin atë shtet, land dhe çdo nënndarje politike apo autoritet lokal. Megjithatë, ky term nuk përfshin personat që janë të detyruar të paguajnë taksa në atë shtet, në lidhje vetëm me të ardhurat nga burimet në atë shtet ose me kapitalin që ndodhet në të.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident i të dy shteteve kontraktuese, statusi i tij përcaktohet si më poshtë:

a) ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka banesën e përhershme në dispozicion; nëse ka në dispozicion banesë të përhershme në të dyja shtetet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit me të cilin ka marrëdhënie më të afërta personale dhe ekonomike (qendra e interesave jetësorë);

b) nëse shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetësorë nuk mund të përcaktohet ose nëse nuk ka banesë të përhershme në dispozicion në secilin shtet, ai konsiderohet banor vetëm i atij shteti në të cilin ai ka qëndrim të zakonshëm;

c) nëse ka qëndrim të zakonshëm në të dyja shtetet ose në asnjë prej tyre, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit, shtetas i të cilit ai është;

d) nëse është shtetas i të dy shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese e zgjidhin çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person i ndryshëm nga një individ, është rezident i të dyja shteteve kontraktuese, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit të tij efektiv.

4. Një ortakëri konsiderohet të jetë rezidente e shtetit kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv. Megjithatë, nenet 6 deri 22 të kësaj Marrëveshjeje aplikohen vetëm për të ardhurat ose kapitalin e ortakërisë që është subjekt tatimesh në shtetin kontraktues, rezidente e së cilës ajo konsiderohet të jetë.

Neni 5

Vendqëndrimi i përhershëm

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi "vendqëndrim i përhershëm" nënkupton një vend të përhershëm biznesi nëpërmjet të cilit drejtohet aktiviteti i një ndërmarrjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

2. Termi "vendqëndrim i përhershëm" përfshin në veçanti:

a) një vend menaxhimi

b) një degë,

c) një zyrë,

d) një fabrikë,

e) një punishte dhe

f) një minierë, një pus nafte ose gazi, një gurore ose një vend tjetër të nxjerrjes së burimeve natyrore.

3. Termi "vendqëndrim i përhershëm" gjithashtu përfshin një shesh ndërtimi, një projekt ndërtimi ose instalimi apo aktivitetet mbikëqyrëse në lidhje me të, por vetëm kur ky shesh, projekt ose aktivitet vazhdon për një periudhë prej më shumë se nëntë muajsh në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore që fillon ose mbaron në vitin fiskal përkatës.

4. Pavarësisht nga dispozitat pararendëse të këtij neni, termi "vendqëndrim i përhershëm" konsiderohet të mos përfshijë:

a) mjediset që përdoren vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje të mallrave ose sendeve që i përkasin ndërmarrjes;

b) rezerva sendesh ose mallrash të ndërmarrjes që i përkasin ndërmarrjes, vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje;

c) rezerva sendesh ose mallrash të ndërmarrjes që i përkasin ndërmarrjes, vetëm për qëllime të përpunimit nga një ndërmarrje tjetër;

d) një vend i përhershëm biznesi vetëm për qëllime të blerjes së mallrave ose sendeve, ose të mbledhjes së informacionit për ndërmarrjen;

e) një vend i përhershëm biznesi vetëm për qëllim të ushtrimit nga ana e ndërmarrjes, të çdo aktiviteti tjetër me karakter përgatitor ose ndihmës;

f) një vend i përhershëm biznesi vetëm për ushtrimin e disa aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët "a" deri "e", me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit të përhershëm të biznesit që rezulton nga veprimtaritë përkatëse, të jetë me karakter përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 6, vepron në emër të një ndërmarrjeje, si dhe që ka dhe ushtron rregullisht në një shtet kontraktues autoritet për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, ajo ndërmarrje do të konsiderohet të ketë vendqëndrim të përhershëm në atë shtet në lidhje me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, me përjashtim të rasteve kur aktivitetet e atij personi kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4, të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi të përhershëm biznesi, nuk do ta bënin këtë të fundit vendqëndrim të përhershëm sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje nuk do të konsiderohet të ketë vendqëndrim të përhershëm në një shtet kontraktues thjesht sepse drejton biznesin në atë shtet nëpërmjet një agjenti, komisioneri tregtar të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, përsa kohë që këta persona të veprojnë sipas rregullave standarde të biznesit të tyre.

7. Fakti që një kompani, e cila është rezidente e një shteti kontraktues, kontrollon ose kontrollohet nga një kompani e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues ose që drejton biznesin në atë shtet tjetër (qoftë nëpërmjet vendqëndrimit të përhershëm apo ndryshe), nuk do të thotë që njëra prej kompanive është vendqëndrim i përhershëm i kompanisë tjetër.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat që rrjedhin nga një rezident i një shteti kontraktues nga pasuria e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria) të ndodhura në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Termi "pasuri e paluajtshme" do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të shtetit kontraktues në të cilin ndodhet prona në fjalë. Në çdo rast, termi do të përfshijë pajisjet në funksion të pasurisë së paluajtshme, gjësë së gjallë dhe pajisjeve të përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me tokën në pronësi, të drejtën e përdorimit të pasurisë së paluajtshme dhe të drejtat për pagesat variable ose fikse si shpërblim për punën ose të drejtën për të punuar, depozitat minerare, burimet dhe rezervat e tjera natyrore; anijet dhe avionët nuk do të konsiderohen si pasuri e paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, dhënia me qira, ashtu si dhe përdorimi në çdo formë tjetër i pasurisë së paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, të përdorura për ushtrimin e një veprimtarie të pavarur.

Neni 7

Fitimet e ndërmarrjes

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet, me përjashtim të rasteve, kur ndërmarrja ushtron veprimtarinë e saj në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një vendqëndrimi të përhershëm të vendosur në të. Nëse ndërmarrja drejton biznesin siç është përmendur më lart, fitimet e ndërmarrjes mund të tatohen në shtetin tjetër, por vetëm për atë pjesë që i atribuohet atij vendqëndrimi të përhershëm.

2. Kur një ndërmarrje e një shteti kontraktues ushtron veprimtarinë e saj në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një vendqëndrimi që ndodhet atje, atëherë, duke pasur parasysh kushtet e përcaktuara në paragrafin 3-në secilin shtet kontraktues këtij vendqëndrimi, do t'i atribuohen këto fitime që mund të kishte nxjerrë, nëse do të kishte qenë një ndërmarrje tërësisht më vete dhe e pavarur, që do të ushtronte një veprimtari të njëjtë ose të ngjashme në kushte të njëjta ose të ngjashme në mënyrë krejtësisht të pavarur nga ndërmarrja, vendqëndrimi i së cilës ai është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një vendqëndrimi të përhershëm, do të lejohen si zbritje shpenzimet që janë bërë për qëllime të vendqëndrimit të përhershëm, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative të bëra qoftë në shtetin në të cilin ndodhet vendqëndrimi i përhershëm, ose diku tjetër.

4. Për sa kohë është e zakonshme që në një shtet kontraktues fitimet që mund t'i atribuohen një vendqëndrimi përcaktohen nëpërmjet ndarjes të fitimeve totale të ndërmarrjes ndaj pjesëve të saj të ndryshme, paragrafi 2 nuk përjashton mundësinë që ky shtet kontraktues fitimet e tatueshme t'i përcaktojë sipas ndarjes proporcionale të zakonshme për atë shtet; megjithatë, metoda e zgjedhur e ndarjes së fitimeve duhet të jetë e tillë në mënyrë që rezultati të jetë në përputhje me parimet e këtij neni.

5. Asnjë fitim nuk do t'i atribuohet vendqëndrimit të përhershëm vetëm për shkak të blerjes nga ai vendqëndrim i përhershëm të mallrave për ndërmarrjen.

6. Për qëllime të paragrafëve të mësipërm, fitimet që do t'i atribuohen vendqëndrimit të përhershëm, do të përcaktohen me anë të së njëjtës metodë vit pas viti, për sa kohë që nuk ka arsye të fortë dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

7. Kur fitimet përfshijnë zërat e të ardhurave që trajtohen në nenet e tjera të Marrëveshjes, dispozitat e atyre neneve nuk do të cenohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8
Transporti detar dhe ajror

1. Fitimet nga përdorimi i anijeve dhe avionëve në transportin ndërkombëtar do të tatohen vetëm në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

2. Nëse vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes detare është në bordin e një anijeje, atëherë ky vend i menaxhimit efekt do të konsiderohet të jetë në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet porti ku anija është e regjistruar ose nëse nuk është e regjistruar, në shtetin kontraktues në të cilin operatori i anijes është rezident.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen gjithashtu për përfitimet nga pjesëmarrja në një ortakëri, biznes të përbashkët ose agjenci operuese ndërkombëtare.

Neni 9
Ndërmarrjet e asociuara

1. Në rastet kur:

a) një ndërmarrje e një shteti kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues; ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues dhe një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues, dhe kur në këto raste, në marrëdhëniet tregtare ose financiare ndërmjet dy ndërmarrjeve ekzistojnë ose janë vendosur kushte, të cilat ndryshojnë nga ato që do të ishin vendosur ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, atëherë fitimet që mund të kishte nxjerrë njëra nga ndërmarrjet po të mos i viheshin këto kushte, por që për shkak të këtyre kushteve nuk mund të nxirren, mund të përfshihen në fitimet e kësaj ndërmarrjeje dhe të tatohen përkatësisht.

2. Kur një shtet kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të këtij shteti dhe taton përkatësisht fitimet për të cilat është tatuar një ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues në atë shtet dhe kur fitimet e përfshira janë fitime që ndërmarrja e shtetit të përmendur më parë mund t'i kishte nxjerrë nëse kushtet për të cilat do të kishin rënë dakord, do të kishin qenë ato mes dy ndërmarrjeve të pavarura, atëherë shteti tjetër do të bëjë rregullimin përkatës, të shumës së taksave të vendosura për këto fitime. Në përcaktimin e këtyre rregullimeve duhet të mbahen në konsideratë dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe nëse është e domosdoshme, autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese do të konsultohen me njëra-tjetrën.

Neni 10
Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një kompani që është rezidente e një shteti kontraktues ndaj një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të tatohen gjithashtu në shtetin kontraktues në të cilin është rezidente kompania që paguan dividendët dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i shtetit tjetër kontraktues, taksa e vendosur nuk do të tejkalojë:

a) 5 për qind të sasisë bruto të dividendëve nëse pronari përfitues është një kompani (e ndryshme nga një ortakëri), që zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë të paktën 25 për qind të kapitalit të kompanisë që paguan dividendët;

b) 15 për qind të sasisë bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Ky paragraf nuk do të cenojë tatimin e kompanisë në lidhje me fitimet nga të cilat janë

paguar dividendët.

3. Termi “dividendë” siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga aksionet, aksionet e “zotërimit/gëzimit” ose të drejtat e “zotërimit/gëzimit”, aksionet e minierave, aksionet e themeluesve ose të drejta të tjera që nuk janë detyrime borxhi, që marrin pjesë në fitime ose të ardhura të tjera, të cilat në përputhje me ligjet e shtetit në të cilin kompania që bën shpërndarjen është rezidente, i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor sikurse të ardhurat nga aksionet.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një shteti kontraktues drejton biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin kompania që paguan dividendët është rezidente, nëpërmjet një vendqëndrimi të përhershëm të vendosur në të ose kryen në atë shtet shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe që aksioni në lidhje me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me vendqëndrimin e përhershëm ose bazën fikse. Në këtë rast, do të zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose 14.

5. Kur një kompani, e cila është rezidente në një shteti kontraktues, nxjerr fitime ose të ardhura nga shteti tjetër kontraktues, atëherë shteti tjetër mund të mos vendosë tatim për dividendët e paguar nga kompania, me përjashtim të rasteve kur dividendët janë paguar për një rezident të shtetit tjetër ose kur aksioni për të cilin janë paguar dividendët, lidhet faktikisht me një vendqëndrim të përhershëm ose një vend fiks biznesi që ndodhet në shtetin tjetër, dhe as t’i nënshtrojë fitimet e pashpërndara të kompanisë tatimit mbi fitimet e pashpërndara të kompanisë edhe nëse dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht prej fitimeve ose të ardhurave të nxjerra në shtetin tjetër.

Neni 11
Interesi

1. Interesi i nxjerrë në një shtet kontraktues dhe i paguar ndaj një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, ky interes mund edhe të tatohet në shtetin kontraktues në të cilin ai nxirret dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i interesit është rezident i shtetit tjetër kontraktues, taksa e vendosur nuk do të tejkalojë 5 për qind të shumës bruto të interesit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2:

a) Interesi që lind në Shqipëri dhe i paguar për një hua të garantuar nga Gjermania në lidhje me eksportin ose investimin e huaj të drejtpërdrejtë ose i paguar për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, Deutsche Bundesbank, Kreditanstalt fur Wiederaufbau ose Deutsche Investititons-und Entëicklungsgesellschaft, do të përjashtohet nga taksat shqiptare;

b) Interesi që lind në Gjermani dhe i paguar për një hua të garantuar nga Shqipëria për eksport apo investim të drejtpërdrejtë të huaj apo që i paguhet Qeverisë së Shqipërisë ose Bankës së Shqipërisë, do të përjashtohet nga tatimi gjerman.

4. Termi “interes”, siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga detyrimet e borxhit të çdo lloji, i siguruar apo jo me hipotekë dhe në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë qeveritare dhe të ardhurat nga obligacionet dhe dëftesat e borxhit, duke përfshirë primet dhe çmimet që i bashkëlidhen atyre letrave me vlerë, obligacioneve ose dëftesave borxhi. Në kuptim të këtij neni, tarifat e gjobës për vonesë pagese nuk do të konsiderohen si interesa.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 deri në 3 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i interesit, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, drejton biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin lind interesi, nëpërmjet një vendqëndrimi të përhershëm të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe detyrimi i borxhit në lidhje me të cilin është paguar interesi, është efektivisht i lidhur me këtë vendqëndrim të përhershëm ose bazë fikse. Në këtë rast, do të zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose 14.

6. Interesi do të konsiderohet të lindë në një shtet kontraktues kur paguesi është rezident i atij shteti. Megjithatë, kur një person që paguan interesin, qoftë rezident i shtetit kontraktues apo

jo, ka në një shtet kontraktues vendqëndrim të përhershëm ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka ndodhur mbetja e borxhit mbi të cilën është paguar interesi dhe ky interes përballohet nga ky vendqëndrim i përhershëm ose bazë fikse, atëherë interesi do të konsiderohet të lindë në shtetin në të cilin ndodhet vendqëndrimi i përhershëm ose baza fikse.

7. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë midis paguesit dhe pronarit përfitues ose midis të dyve dhe një personi tjetër, shuma e interesit, duke marrë parasysh detyrimin e borxhit për të cilin është paguar, tejkalon shumën për të cilën do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, atëherë dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke i kushtuar vëmendje dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje.

Neni 12

Të ardhurat nga të drejtat e autorit

1. Të ardhurat nga të drejtat e autorit që lindin në një shtet kontraktues dhe të paguara ndaj një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, të ardhurat nga të drejtat e autorit mund të tatohen gjithashtu në shtetin kontraktues në të cilin ato lindin dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i të ardhurave nga të drejtat e autorit, është rezident i shtetit tjetër kontraktues, taksa e vendosur nuk do të tejkalojë 5 (pesë) për qind të shumës bruto të të ardhurave nga të drejtat e autorit.

3. Termi "të ardhurat nga të drejtat e autorit" siç përdoret në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji të marra në lidhje me përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte autori të veprës letrare, artistike ose shkencore, duke përfshirë filma kinematografikë, çdo patentë, markë, projektim ose model, plan, formulë sekrete ose proces, apo informacion në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore. Termi "të ardhurat nga të drejtat e autorit" do të përfshijë gjithashtu pagesat e çdo lloji për përdorimin ose të drejtën për të përdorur një emër personi, fotografi ose çdo të drejtë tjetër të ngjashme personaliteti dhe mbi pagesat e marra në lidhje me regjistrimin e performancave të subjekteve argëtuese ose sportistëve me anë të radios ose televizionit.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i të ardhurave nga të drejtat e autorit, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, drejton biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin lindin të ardhurat nga të drejtat e autorit, nëpërmjet një vendqëndrimi të përhershëm të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe e drejta ose pronësia në lidhje me të cilat janë paguar të ardhurat nga të drejtat e autorit, është e lidhur efektivisht me këtë vendqëndrim të përhershëm ose bazë fikse. Në këtë rast, do të zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

5. Të ardhurat nga të drejtat e autorit do të konsiderohen të lindin në një shtet kontraktues kur paguesi është rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan të ardhurat nga të drejtat e autorit, qoftë rezident i shtetit kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues vendqëndrim të përhershëm ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka rrjedhur përgjegjësia për të paguar të ardhurat nga të drejtat e autorit dhe këto të ardhura përballohen nga ky vendqëndrim i përhershëm ose vend fiks, atëherë këto të ardhura do të konsiderohen të lindin në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet vendqëndrimi i përhershëm ose vendi fiks.

6. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë midis paguesit dhe pronarit përfitues ose midis të dyve dhe një personi tjetër, shuma e të ardhurave nga të drejtat e autorit, duke marrë në konsideratë përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin ato janë paguar, tejkalon shumën për të cilën do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, atëherë dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet

kontraktues, duke i kushtuar vëmendje dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13
Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë ose i kapitalit

1. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një shteti kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të përmendur në nenin 6 dhe të ndodhur në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një shteti kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve dhe të drejtave të ngjashme që nxjerrin më shumë sesa 50 për qind të vlerës së tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga pasuria e paluajtshme e ndodhur në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme që përbëjnë pjesë të pasurisë së biznesit të një vendqëndrimi të përhershëm, të cilin një ndërmarrje e një shteti kontraktues e ka në shtetin tjetër kontraktues ose të pasurisë së luajtshme që i përket një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një shteti kontraktues në shtetin tjetër kontraktues për qëllime të kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, duke përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i këtij vendqëndrimi të përhershëm (vetëm ose me gjithë ndërmarrjen) ose të kësaj baze fikse, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

4. Fitimet nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që përdoren në transportin ndërkombëtar ose pasurisë së luajtshme që i shërben përdorimit të këtyre anijeve ose avionëve, do të tatohen vetëm në atë shtet kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie të ndryshme nga ajo e përmendur në paragrafët 1 deri në 4, do të tatohen vetëm në shtetin kontraktues në të cilin tjetërsuesi është rezident.

6. Kur një person fizik, i cili ka pasur vendbanim në një shtet kontraktues për një periudhë prej të paktën 5 (pesë) vjetësh dhe është bërë rezident i shtetit tjetër kontraktues, paragrafi 5 nuk e pengon shtetin e parë kontraktues të tatojë, sipas ligjeve të tij të brendshme, vlerën e rritur të kapitalit të aksioneve në një kompani rezidente në atë shtet, për periudhën në të cilin personi fizik ka qenë rezident i shtetit të përmendur më parë. Në këtë rast, vlera e rritur e pasurisë, e tatuar në shtetin kontraktues të përmendur më parë, nuk do të përfshihet në përcaktimin e vlerës së rritur të mëvonshme të kapitalit prej atij shteti.

Neni 14
Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat, që një person fizik rezident i një shteti kontraktues mund të nxjerrë prej shërbimesh profesionale ose aktivitetesh të tjera të një karakteri të pavarur, do të tatohen vetëm në atë shtet, përveç rrethanave të mëposhtme kur këto të ardhura mund të tatohen edhe në shtetin tjetër kontraktues:

a) nëse ky person ka rregullisht në dispozicion një bazë të përhershme për ushtrimin e veprimtarisë së tij në shtetin tjetër kontraktues, atëherë në këtë rast të ardhurat mund të tatohen në shtetin tjetër vetëm në atë masë që ato mund t'i atribuohen asaj baze të përhershme; ose

b) kur personi në fjalë brenda një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, e cila fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës, qëndron gjithsej 183 ditë ose më shumë në shtetin tjetër, atëherë të ardhurat mund të tatohen në shtetin tjetër vetëm në atë masë që ato burojnë nga veprimtaria e ushtruar në shtetin tjetër.

2. Termi "shërbime personale të pavarura" përfshin veçanërisht aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore ose didaktike, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, dentistëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve dhe ekspertëve kontabël.

Neni 15
Të ardhurat nga punësimi

1. Në respekt të neneve 16 deri në 20, rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme që një rezident i një shteti kontraktues përfiton nga puna jo e pavarur, mund të tatohen vetëm në këtë shtet, me përjashtim të rasteve kur puna në fjalë ushtrohet në shtetin tjetër kontraktues. Nëse puna ushtrohet atje, atëherë shpërblimi i marrë për të mund të tatohet në shtetin tjetër kontraktues.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimi që një rezident i një shteti kontraktues përfton në lidhje me punësimin e ushtruar në shtetin tjetër kontraktues, do të tatohet vetëm në shtetin e përmendur më parë, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) marrësi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore, e cila fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës;

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi, i cili nuk është rezident i shtetit tjetër;

c) shpërblimi nuk përballohet nga vendqëndrimi i përhershëm ose baza fikse, të cilën punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht dispozitave pararendëse të këtij neni, shpërblimi i lindur në lidhje me një punë të ushtruar në bordin e një anijeje ose avionit të përdorur në transportin ndërkombëtar, mund të tatohet në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes që operon anijen ose avionin.

Neni 16
Shpërblimi për bordin drejtues

Tarifat e drejtuesve dhe pagesa të tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtuesve ose një organi të ngjashëm të një firme e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

Neni 17
Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, të ardhurat që merren nga një rezident i një shteti kontraktues në rolin e subjektit argëtues, si artist teatri, filmi, radioje ose televizioni ose muzikant apo sportist, nga aktivitetet e tij personale të ushtruara në këtë mënyrë në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një subjekt argëtues ose sportist në cilësinë e tij si i tillë, nuk i shtohen subjektit argëtues ose sportistit, por personit tjetër, ato të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, mund të tatohen në shtetin kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e subjektit argëtues apo sportistit.

3. Paragrafët 1 dhe 2 nuk do të zbatohen për të ardhurat që rriten nga ushtrimi i aktiviteteve nga artistë ose sportistë në një shtet kontraktues, kur vizita në atë shtet financohet tërësisht ose pjesërisht nga fondet publike të shtetit tjetër, një landi, një nënndarjeje politike ose një autoriteti lokal apo nga një organizatë, e cila në atë shtet tjetër njihet si organizatë bamirëse. Në këtë rast, të ardhurat mund të tatohen vetëm në shtetin kontraktues, në të cilin individi është rezident.

Neni 18
Pensionet, pensionet vjetore dhe pagesa të ngjashme

1. Duke marrë në konsideratë kushtet e parashtruara të paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe pagesat e ngjashme ose pensionet vjetore të paguara ndaj një rezidenti të një shteti kontraktues nga shteti tjetër kontraktues, do të tatohen vetëm në shtetin e përmendur më parë.

2. Pavarësisht dispozitave e paragrafit 1, pagesat e përsëritura ose të njëhershme, të kryera nga një prej shteteve kontraktuese ose nga njësitë e tij administrative territoriale një personi rezident në shtetin tjetër kontraktues, si kompensim për persekutimin politik, për padrejtësi apo dëme si rezultat i veprimeve luftarake (duke përfshirë pagesa rikompensimi) shërbimit ushtarak apo shërbimeve alternative civile ose për shkak të një krimi, një vaksinimi ose ngjarjesh të ngjashme, do të tatohen vetëm në shtetin e përmendur më parë.

3. Termi "pensione vjetore" nënkupton shuma të pagueshme periodikisht në kohë të caktuara për të gjithë jetën ose për një periudhë kohe të përcaktuar, si një detyrim që këto pagesa të kryhen si kompensim i plotë dhe i përshtatshëm në para ose në vlerë monetare.

Neni 19

Shërbimi publik

1. a) Rrogat, pagat dhe shpërblime e ngjashme, me përjashtim të pensioneve, që një shtet kontraktues, një land i tij, një njësi e tij lokale ose një njësi e tij administrative territoriale apo një person i tij juridik i së drejtës publike i paguan një personi fizik, për shërbimet, që ky person ka kryer për këtë shtet, për njërin prej landeve të tij, njërën prej njësive të tij administrative territoriale ose për një person juridik të së drejtës publike, do të tatohen vetëm në këtë shtet.

b) Megjithatë, këto rroga, paga dhe shpërblime të ngjashme do të tatohen vetëm në shtetin tjetër kontraktues, nëse shërbimet në fjalë janë kryer në këtë shtet dhe personi fizik e ka vendbanimin e tij në këtë shtet dhe;

i) është shtetas i atij shteti ose

ii) nuk është bërë rezident i këtij shteti vetëm për qëllim kryerjen e shërbimeve në fjalë.

2. a) Çdo lloj pensioni i paguar nga një shtet kontraktues, një land i tij, një njësi e tij administrative territoriale ose një person i tij juridik i së drejtës publike apo nga një fond i posaçëm i krijuar nga ky shtet kontraktues, ky land, kjo njësi administrative territoriale ose ky person juridik i së drejtës publike një personi fizik për shërbime të kryera për këtë shtet, për njërin prej landeve të tij, njerën prej njësive të tij administrative territoriale ose për një person juridik të së drejtës publike, do të tatohet vetëm në këtë shtet.

b) Gjithsesi, këto pensione do të tatohet vetëm në shtetin tjetër kontraktues, në rast se personi fizik është rezident dhe shtetas i këtij shteti.

3. Lidhur me rrogat, pagat e shpërblimet e ngjashme, si dhe pensionet për shërbimet e kryera në lidhje me një veprimtari biznesi të drejtuar të një shteti kontraktues, një landi të tij, një njësie të tij administrative territoriale ose një personi të tij juridik, të së drejtës publike, gjejnë zbatim nenet 15, 16, 17 ose 18.

4. Dispozitat e paragrafit 1 vlejnë përkatësisht për shpërblimet, të cilat paguhen në kuadër të një programi të bashkëpunimit ekonomik të një shteti kontraktues, një landi të tij ose një njësie të tij administrative territoriale, nga mjetet financiare, që vihen në dispozicion ekskluzivisht nga ky shtet, land ose njësi administrative territoriale, për specialistë ose ndihmës vullnetarë, të cilët janë dërguar në shtetin tjetër kontraktues me miratimin e këtij të fundit.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 gjejnë zbatim edhe për rrogat, pagat dhe shpërblimet e ngjashme, si dhe pensionet, të cilët u paguhen personave për shërbimet, që kryen për Institutin Gëte (Goethe-Institut) për Entin Gjerman të Shkëmbimeve Akademike (Deutscher Akademischer Austauschdienst, DAAD) dhe për institucione të ngjashme në shtetet kontraktuese, siç është rënë dakord në mirëkuptim të ndërsjellë mes autoriteteve kompetente. Në rast se shpërblimet në fjalë nuk tatohen në shtetin ku është themeluar institucioni, atëherë do të gjejnë zbatim dispozitat e nenit 15.

Neni 20
Profesorët e ftuar, mësuesit dhe studentët

1. Një person fizik, i cili viziton një shtet kontraktues me ftesë të atij shteti ose universiteti, kolegji, shkolle, muzeumi apo institucioni tjetër kulturor të atij shteti ose në kuadër të një programi zyrtar të shkëmbimit kulturor për një periudhë që nuk i kalon dy vjet, vetëm për qëllime mësimdhënieje, dhënie leksionesh ose kryerjes së kërkimeve shkencore në këtë institucion dhe që është ose ka qënë menjëherë para vizitës në shtetin kontraktues, përmendur më parë, rezident i shtetit tjetër Kontraktues, do të përjashtohet nga taksa në shtetin e përmëndur më parë, në lidhje me shpërblimin e tij për këtë aktivitet, me kusht që ky shpërblim të burojë nga jashtë atij shteti.

2. Një student apo praktikant, i cili është ose ka qenë menjëherë para vizitës së një shteti kontraktues, rezident i shtetit tjetër kontraktues dhe që është i pranishëm në shtetin e përmendur më parë vetëm për qëllime të edukimit ose trajnimit të tij, nuk do të tatohet në atë shtet për pagesat që ai merr për qëllime të jetesës, edukimit ose trajnimit të tij, me kusht që këto pagesa të burojnë jashtë atij shteti.

3. Për sa u përket grandeve, bursave dhe shpërblimeve nga punësimi, të cilat nuk mbulohen nga paragrafi 2, një student apo praktikant i përshkruar në paragrafin 2, për më tepër, do të ketë të drejtë të gëzojë gjatë kësaj periudhe edukimi ose trajnimi të njëjtat përjashtime, lehtësira ose reduktime të taksave në dispozicion, në të njëjtat kushte sikurse rezidentët e shtetit të cilin po viziton.

Neni 21
Të ardhura të tjera

1. Të ardhurat të një rezidenti të një shteti kontraktues, kudo ku burojnë ato të patrajtuara në nenet pararendëse të kësaj marrëveshjeje, do të tatohen vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk gjejnë zbatim për të ardhura të tjera nga të ardhurat e pasurisë së paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse marrësi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, drejton një aktivitet sipërmarrës në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një vendqëndrimi të përhershëm të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër punë të pavarura nga një vendqëndrim i përhershëm i vendosur në të dhe e drejta ose prona në lidhje me të cilat janë paguar të ardhurat është efektivisht e lidhur me atë vendqëndrim të përhershëm ose bazë fikse. Në këtë rast, gjejnë zbatim sipas rastit dispozitat e nenit 7, respektivisht nenit 14.

Neni 22
Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e paluajtshme sipas nenit 6, i zotëruar nga një rezident i një shteti kontraktues dhe i ndodhur në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e luajtshme që përbën pjesë të pronës së biznesit të një vendqëndrimi të përhershëm, që një sipërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues ose nga pasuria e luajtshme që i përket një vendqëndrimi të përhershëm në dispozicion të një rezidenti të një shteti kontraktues në shtetin tjetër kontraktues, për qëllim të kryerjes së punëve të pavarura, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anijet dhe avionët e përdorur në transportin ndërkombëtar dhe nga pasuria e luajtshme në funksion të përdorimit të këtyre anijeve dhe avionëve, do të tatohet vetëm në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një shteti kontraktues do të tatohen vetëm në atë shtet.

Neni 23

Shmangia e tatimit të dyfishtë në shtetin e rezidencës

1. Në rastin e një rezidenti të Gjermanisë, taksa do të përcaktohet si më poshtë:

a) Përveç rasteve të kreditimit të tatimit të huaj të lejuar sipas nënparagrafit "b", nga baza e vlerësimit të taksës gjermane do të përjashtohet çdo zë i të ardhurave me burim në Shqipëri dhe çdo zë i kapitalit me vendndodhje në Shqipëri, të cilat, me këtë Marrëveshjeje, mund të tatohen në Shqipëri.

Në rast të zërave të të ardhurave nga dividendët, dispozita pararendëse do të zbatohet vetëm për ata dividendë që i janë paguar një firme (pa përfshirë ortakëritë), që është rezidente e Gjermanisë, nga një firmë që është rezidente e Shqipërisë, të paktën 25 për qind e kapitalit të të cilit zotërohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga firma gjermane dhe që nuk janë zbritur kur janë përcaktuar fitimet e firmës që shpërndante këta dividendë.

Do të përjashtohet nga baza e vlerësimit të taksave gjermane mbi kapitalin, aksioni dividendët e të cilët, nëse do të paguheshin, do të përjashtoheshin nga baza e vlerësimit të taksave sipas fjalive të mësipërme.

b) duke pasur parasysh dispozitat e së drejtës tatimore gjermane mbi kreditimin e taksave të huaja, përsa u përket të ardhurave të mëposhtme, për taksën gjermane mbi të ardhurat do të lejohet kreditimi i taksave shqiptare, të paguara për këto të ardhura sipas të drejtës shqiptare dhe në përputhje me këtë Marrëveshje:

aa) dividendët që nuk janë trajtuar në nënparagrafin "a";

bb) interesat;

cc) të ardhurat nga e drejta e autorit;

dd) zërat e të ardhurave që mund të tatohen në Shqipëri sipas paragrafit 2 të nenit 13;

ee) zërat e të ardhurave që mund të tatohen në Shqipëri sipas paragrafit 3 të nenit 15;

ff) shpërblimi për anëtarët e bordit drejtues ose administrues;

gg) zërat e të ardhurave që mund të tatohen sipas nenit 17.

c) dispozitat e nënparagrafit "b" do të zbatohen në vend të dispozitave të nënparagrafit "a" për zërat e të ardhurave, siç përcaktohen në nenet 7 dhe 10 dhe për vlerat pasurore (asetet), nga të cilat kanë rrjedhur këto të ardhura, nëse rezidenti i Gjermanisë nuk provon se të ardhurat bruto të vendqëndrimit të përhershëm në vitin fiskal në të cilin janë realizuar fitimet prej tij ose prej firmës rezidente në Shqipëri në vitin e biznesit për të cilin janë paguar dividentët, kanë rrjedhur ekskluzivisht ose pothuajse ekskluzivisht nga aktivitete sipas kuptimit të dispozitave 1 deri në 6 të paragrafit 1 të seksionit 8 të legjislacionit gjerman mbi marrëdhëniet tatimore të jashtme (Aussensteuergesetz); e njëjta gjë vlen për pasurinë e paluajtshme të përdorur nga një vendqëndrim i përhershëm dhe për të ardhurat nga kjo pasuri e paluajtshme e vendqëndrimit të përhershëm (paragrafi 4 i nenit 6) dhe për fitimet nga tjetërsimi i kësaj pasurie të paluajtshme (paragrafi 1 i nenit 13) dhe i pasurisë së luajtshme, që bëhet pjesë e pronës së biznesit të vendqëndrimit të përhershëm (paragrafi 3 i nenit 13).

d) Megjithatë, Gjermania rezervon të drejtën të marrë në konsideratë në përcaktimin e përqindjes së taksës, zërat e të ardhurave dhe kapitalin që sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, përjashtohen nga taksa gjermane.

e) Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit "a", tatimi i dyfishtë do të shmanget duke lejuar kreditimin e tatimit sipas përcaktimeve të nënparagrafin "b".

aa) Nëse në shtetet kontraktuese, zërat e të ardhurave ose kapitalit vendosen sipas dispozitave të ndryshme të kësaj Marrëveshjeje ose u atribuohen personave të ndryshëm (përveçse kur parashikohet në nenin 9) dhe ky konflikt nuk mund të zgjidhet me anë të një procedure në përputhje me paragrafin 3 të nenit 25 dhe nëse si rezultat i këtij ndryshimi në

vendosje ose atribuim, të ardhurat përkatëse ose kapitali do të mbeteshin të patatuara ose do të tatoheshin më pak sesa pa këtë konflikt ose

bb) Nëse pas konsultimit të duhur me autoritetin kompetent të Shqipërisë, Gjermania njofton Shqipërinë nëpërmjet rrugëve diplomatike në lidhje me zëra të tjerë të të ardhurave për të cilat synon të zbatojë dispozitat e nënparagrafit "b". Më pas, tatimi i dyfishtë shmanget për të ardhurat e njoftuara me anë të lejimit të një kredie takse nga dita e parë e vitit kalendarik, duke pasuar atë në të cilin është bërë njoftimi.

2. Në rast të një rezidenti në Shqipëri, taksa do të përcaktohet si më poshtë:

a) Kur një rezident i Shqipërisë nxjerr të ardhura ose zotëron kapital, i cili në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të tatohet në Gjermani, Shqipëria do të lejojë:

aa) si zbritje nga taksa shqiptare mbi të ardhurat e atij shteti, një shumë të barabartë me taksën e të ardhurave të paguar në Gjermani; dhe

bb) si zbritje nga taksa shqiptare mbi kapitalin e atij rezidenti, një shumë të barabartë me taksën e kapitalit të paguar në Gjermani.

Megjithatë, kjo zbritje në çdo rast nuk do të tejkalojë atë pjesë të taksës shqiptare mbi të ardhurat ose mbi kapitalin që është llogaritur para se të jepej zbritja, e cila iu atribuohet sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohet në Gjermani.

b) Kur në përputhje me çdo dispozitë të Marrëveshjes, të ardhurat që rrjedhin ose kapitali i zotëruar nga një rezident i Shqipërisë përjashtohet nga taksa në Shqipëri, në llogaritjen e sasisë së taksave mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur, Shqipëria, megjithatë, mund të marrë në konsideratë të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

Neni 24

Trajtim me të drejta të barabarta

1. Shtetasit e një shteti kontraktues nuk do t'i nënshtrohen tatimit të shtetit tjetër kontraktues ose çdo kërkese në lidhje me të që ndryshon ose është më e rreptë sesa tatimi dhe detyrimet përkatëse të cilave shtetasit e atij shteti tjetër u janë nënshtruar apo mund t'i nënshtrohen në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me rezidencën. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, kjo dispozitë do të zbatohet edhe ndaj personave të cilët nuk janë rezidentë të një ose të dy shteteve kontraktuese.

2. Personat pa shtetësi të cilët janë rezidentë të një shteti kontraktues, nuk do t'i nënshtrohen në asnjë shtet kontraktues ndonjë tatimi ose kërkesave në lidhje me të, që janë të ndryshme ose më të rrepta sesa tatimi dhe detyrimet përkatëse të cilave shtetasit e shtetit të interesuar u janë nënshtruar apo mund t'u nënshtrohen në të njëjtat rrethana.

3. Tatimi mbi një vendqëndrim të përhershëm që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues, nuk do të vendoset në mënyrë më pak të favorshme në atë shtet tjetër sesa tatimi i vendosur mbi ndërmarrjet e atij shteti tjetër që drejton të njëjtat aktivitete. Kjo dispozitë nuk do të interpretohet si detyruese për një shtet kontraktues për t'u dhënë rezidentëve të shtetit tjetër kontraktues çdo zbritje financiare personale, lehtësira dhe ulje për qëllime tatimore, duke marrë parasysh statusin civil ose përgjegjësitë familjare, të cilat u jep vetëm rezidentëve të vet.

4. Përveç rasteve kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, të paragrafit 7 të nenit 11 ose të paragrafit 6 të nenit 12, interesi, të ardhurat nga e drejta e autorit dhe pagesa të tjera të kryera nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues ndaj një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, për qëllim të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin paguar një rezidenti të shtetit të përmendur më parë. Po ashtu, çdo borxh i një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues ndaj një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, për qëllim të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj ndërmarrjeje, do të jetë i

zbritshëm sipas të njëjtave kushte sikur të ishin kontraktuar me rezidentin e shtetit të përmendur më parë.

5. Ndërmarrjet e një shteti kontraktues, kapitali i të cilave zotërohet tërësisht ose pjesërisht ose kontrollohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga një ose më shumë rezidentë të shtetit tjetër kontraktues, nuk do t'i nënshtrohet asnjë tatimi në shtetin e përmendur më parë ose çdo kërkese në lidhje me të, që është e ndryshme ose më e rreptë sesa tatimi dhe kërkesat e ngjashme, të cilave mund t'i nënshtrohen ndërmarrje të ngjashme të shtetit të përmendur më parë.

6. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht nga dispozitat e nenit 2, do të zbatohen për taksat e çdo lloji dhe përshkrimi.

Neni 25

Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë

1. Kur një person gjykon se veprimet e një ose të dy shteteve kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për të në një mënyrë tatimi e cila nuk përputhet me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga zgjidhjet e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, mund t'ia paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të shtetit kontraktues në të cilin është rezident ose nëse çështja e tij është subjekt i paragrafit 1 të nenit 24, mund t'ua paraqesë atë autoriteteve kompetente të shtetit kontraktues, shtetas i të cilit ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vitesh pas njoftimi të parë të veprimit që gjykohet se rezulton në një tatimin jo në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse autoriteti kompetent e quan këtë kundërshtim të justifikuar dhe nëse ai vetë është në gjendje të arrijë në zgjidhje të kënaqshme, atëherë ai do të përpiqet ta zgjidhë çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë, me autoritetin kompetent të shtetit tjetër kontraktues, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me marrëveshjen. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht ndonjë afati kohor në legjislacionin e brendshëm të shteteve kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese do të përpiqen të zgjidhin me anë të Marrëveshjes së ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e marrëveshjes. Ata gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet të cilat nuk janë parashikuar në marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese mund të komunikojnë me njëra-tjetrën në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke përfshirë një komision të përbashkët që përbëhet prej tyre ose përfaqësuesve të tyre, për qëllim të arritjes së një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

Neni 26

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese do të shkëmbejnë informacion siç parashikohet të jetë i vlefshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose për administrimin dhe zbatimin e ligjeve të brendshme në lidhje me taksat e çdo lloji dhe përshkrimi të vendosur në emër të një shteti kontraktues, landi ose nënndarjeje politike apo autoriteti lokal, për sa kohë që tatimi më poshtë të mos jetë në kundërshtim me Marrëveshjen. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë sipas paragrafit 1 nga një shtet kontraktues do të trajtohet sekret në të njëjtën mënyrë sikurse informacioni i përftuar sipas legjislacionit të brendshëm të atij shteti dhe do të bëhet i ditur vetëm për personat ose autoritetet (duke përfshirë gjykata dhe organe adminsitrative) që merren me vlerësimin ose mbledhjen, përmbarimin e vendimeve gjyqësore ose procedurave për ndjekje penale ose procedurat e apelimit në lidhje me taksat e përmendura në paragrafin 1 apo mbikëqyrjen e sa më sipër. Këta persona ose autoritete do të përdorin

informacion vetëm për këto qëllime. Ata mund ta zbulojnë informacionin në kuadër procesesh gjyqësore publike ose në funksion të një vendimi gjyqësor.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të interpretohen si të tilla që të vendosin mbi një shtet kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative për dhënien e informacionit në mospërputhje me ligjet dhe praktikën administrative të atij shteti kontraktues ose të shtetit tjetër kontraktues;

b) për të dhënë informacion, që nuk është i përftueshëm sipas ligjeve ose në punën normale të administratës së atij shteti kontraktues apo të shtetit tjetër kontraktues;

c) për të dhënë informacion, që do të zbulonte një sekret tregtar, biznesi, industrial, profesional ose proces tregtie apo informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me rendin publik.

4. Nëse informacioni kërkohet nga një shtet kontraktues në përputhje me këtë nen, shteti tjetër kontraktues do të shfrytëzojë mundësitë e veta, duke marrë masa për të siguruar informacionin e kërkuar, edhe pse ai shtet tjetër mund të mos ketë nevojë për këtë informacion për qëllimet e veta tatimore. Detyrimi në përmbajtje të fjalisë pararendëse u nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 3, përveç rasteve kur këto kufizime nuk e pengojnë një shtet kontraktues të japë informacion vetëm sepse nuk ka interes tatimi të brendshëm për atë informacion.

5. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 3 nuk do të interpretohen që një shtet kontraktues të lejohet të refuzojë të japë informacion vetëm ngaqë informacioni disponohet nga një bankë, institucion tjetër financiar, kandidat ose person që vepron në një agjenci ose në mirëbesim apo që ka lidhje me interesat e e pronësisë mbi një person.

Neni 27

Asistencë në mbledhjen e taksave

1. Shtetet kontraktuese do të ndihmojnë njëra-tjetrën në mbledhjen e pretendimeve të të ardhurave tatimore. Kjo asistencë nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, me anë të marrëveshjes së ndërsjellë, mund të zgjidhin mënyrën e zbatimit të këtij neni.

2. Termi "pretendim të ardhurash tatimore" siç përdoret në këtë nen, nënkupton një shumë të papaguar në lidhje me taksat e çdo lloji dhe përshkrimi, të vendosura në emër të një shteti kontraktues, landi ose nënndarjeje politike apo autoriteti lokal, për sa kohë që ky tatim nuk është në kundërshtim me këtë Marrëveshje apo me çdo instrument tjetër në të cilin shtetet kontraktues janë palë, si dhe interesat, gjobat administrative dhe kostot e mbledhjes ose ruajtjes lidhur me këtë shumë.

3. Kur një pretendim të ardhurash i një shteti kontraktues është i zbatueshëm sipas ligjeve të atij shteti dhe është detyrim i pashlyer i një personi, i cili në atë kohë, sipas ligjeve të atij shteti, nuk mund të parandalonte mbledhjen e tij, ky pretendim të ardhurash tatimore, me kërkesë të autoritetit kompetent të atij shteti, do të njihet si i tillë për qëllime të mbledhjes përmes autoritetit kompetent të shtetit tjetër kontraktues. Ai pretendim të ardhurash tatimore do të mblidhet nga ai shtet tjetër në përputhje me dispozitat e veta ligjore rreth zbatimit dhe mbledhjes se taksave të veta, sikur pretendimi i të ardhurave tatimore të ishte pretendim të ardhurash tatimore i atij shteti tjetër.

4. Kur një pretendim të ardhurash tatimore i një shteti kontraktues është detyrim në lidhje me të cilin ai shtet, sipas ligjit të tij, mund të marrë masa të ruajtjes, me synim sigurimin e mbledhjes së tij, ai pretendim të ardhurash tatimore, me kërkesë të autoritetit kompetent të atij shteti, do të njihet si i tillë për qëllim të marrjes së masave të ruajtjes nga autoriteti kompetent i shtetit tjetër kontraktues. Ai shtet tjetër do të marrë masa ruajtjeje në lidhje me atë detyrim të ardhurash në përputhje me dispozitat e ligjeve të tij, sikur pretendimi i të ardhurave të ishte pretendim të ardhurash tatimore i atij shteti tjetër edhe sikur në kohën kur këto masa janë

zbatuar, pretendimi i të ardhurave tatimore nuk është i zbatueshëm në shtetin e përmendur më parë ose është detyrim i një personi, i cili ka të drejtë të parandalojë mbledhjen e tij.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4, një detyrim të ardhurash i pranuar nga një Shtet Kontraktues për qëllime të paragrafit 3 ose 4 në atë shtet, nuk do të jetë objekt i afateve të vjetrimit apo i përcaktimeve për dhënie prioriteti në trajtimin e një pretendimi të ardhurash tatimore sipas ligjeve të atij shteti, për arsye të natyrës së tij si i tillë. Për më tepër, një pretendim të ardhurash tatimore i pranuar nga një shtet kontraktues për qëllime të paragrafit 3 ose 4 në atë Shtet, nuk do të ketë atë prioritet që ky pretendim të ardhurash tatimore ka sipas ligjeve të shtetit tjetër kontraktues.

6. Procedimet në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose sasinë e pretendimit të të ardhurave tatimore të një shteti kontraktues, nuk mund të paraqiten pranë gjykatave ose organeve administrative të shtetit tjetër kontraktues.

7. Nëse pasi është bërë kërkesë nga një shtet kontraktues sipas paragrafit 3 ose 4 dhe para se shteti tjetër kontraktues të ketë mbledhur pretendimet e të ardhurave tatimore në fjalë dhe t'ia ketë derdhur ato shtetit të përmendur më parë pretendimet e të ardhurave tatimore në fjalë humbasin:

a) në rast të një kërkese sipas paragrafit 3, cilësinë e tyre si pretendime të ardhurash tatimore të shtetit të përmendur më parë, të cilat janë të përmbarueshëm sipas legjislacionit të të këtij shteti dhe përbëjnë borxhin e një personi, i cili në atë moment, sipas legjislacionit këtij shteti, nuk mund të pengojë mbledhjen e tyre; ose

b) në rast të një kërkese sipas paragrafit 4, cilësinë e tyre si pretendime të ardhurash tatimore të shtetit të përmendur më parë, lidhur me të cilat ky shtet, sipas legjislacionit të tij, mund të marrë masa për sigurimin e mbledhjes, atëherë autoriteti kompetent i shtetit të përmendur më parë njofton për këtë menjëherë autoritetin kompetent të shtetit tjetër, dhe sipas shprehjes së vullnetit të shtetit tjetër, shteti i përmendur më parë ose do të pezullojë ose do ta tërheqë kërkesën e tij.

8. Në asnjë rast, dispozitat e atij neni nuk do të interpretohen në mënyrë që të vendosin mbi një shtet kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative në kundërshtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij shteti kontraktues ose shtetit tjetër kontraktues;

b) për të realizuar masa që do të ishin në kundërshtim me rendin publik;

c) për të dhënë asistencë nëse shteti tjetër kontraktues nuk ka ushtruar të gjitha masat e arsyeshme të mbledhjes ose mbrojtjes apo ruajtjes, sipas rastit, sipas ligjeve të tij apo praktikës administrative;

d) për të dhënë asistencë në ato raste kur ngarkesa admistrative për atë shtet është dukshëm në disproporcion me fitimin që duhet të nxirret nga shteti tjetër kontraktues.

Neni 28

Rregullat procedurale për tatimin në burim

1. Nëse në një prej shteteve kontraktues taksat mbi dividendët, interesat, të ardhurat nga e drejta e autorit apo mbi të ardhura të tjera të një personi me vendbanim në shtetin tjetër kontraktues, mblidhen me anë të mbajtjes në burim, atëherë nuk preket nga kjo Marrëveshje e drejta e shtetit të përmendur më parë për të tërhequr taksat sipas kuotës së parashikuar nga legjislacioni i tij i brendshëm. Taksapaguesi, me kërkesë të tij, do të kompensohet për taksat e mbajtura në burim, në atë kohë dhe masë që ato ulen ose anulohen nga kjo Marrëveshje.

2. Kërkesat e kompensimit duhet të dorëzohen nga fundi i vitit të katërt pas vitit kalendarik në të cilin taksa që mbahet, aplikohet për dividendët, interesin, tarifat për të drejtat e autorit apo zëra të tjerë të ardhurash.

3. Pavarësisht nga paragrafi 1, secili shtet kontraktues do të parashikojë procedura, me synim që pagesat e të ardhurave të cilat sipas kësaj Marrëveshjeje nuk i nënshtrohen asnjë takse

ose vetëm taksës së reduktuar në shtetin e origjinës, mund të bëhen pa zbritje takse ose me zbritje të taksës vetëm në tarifën e parashikuar në nenin përkatës.

4. Shteti kontraktues në të cilin lindin zërat e të ardhurave, mund të kërkojë një vërtetim nga autoriteti kompetent në lidhje me rezidencën në shtetin tjetër kontraktues.

5. Autoritetet kompetente, me anë të marrëveshjes së ndërsjellë, mund të rregullojnë zbatimin e dispozitave të këtij neni dhe nëse është e nevojshme, të vendosin procedura të tjera për zbatimin e zbritjes ose përjashtimeve të taksave të parashikuara në këtë Marrëveshje.

Neni 29
Zbatimi i Marrëveshjes në raste të veçanta

Kjo Marrëveshje nuk duhet interpretuar sikur një shteti kontraktues i ndalohet zbatimi i dispozitave të tij ligjore të brendshme në lidhje me parandalimin e evazionit fiskal ose shmangien e taksave. Nëse dispozita e mësipërme rezulton në tatim të dyfishtë, autoritetet kompetente do të konsultohen me njëra-tjetrën sipas nenit 25, paragrafi 3, mbi mënyrat e mundshme sesi të shmangin tatimin e dyfishtë.

Neni 30
Anëtarët e përfaqësive diplomatike dhe konsullore

Kjo Marrëveshje nuk i prek privilegjet tatimore, që gëzojnë anëtarët e përfaqësive diplomatike ose konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose në bazë të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 31
Protokolli

Protokolli bashkëlidhur do të jetë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 32
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të ratifikohet; instrumentet e ratifikimit do të shkëmbehen sa më parë të jetë e mundur në Tiranë.

2. Marrëveshja do të hyjë në fuqi ditën e shkëmbimit të instrumenteve të ratifikimit dhe do të ketë fuqi në të dyja shtetet kontraktuese:

a) në rast të taksave të mbajtura në burim, në lidhje me shumat e paguara në ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik vijues, duke ndjekur atë në të cilin Marrëveshja ka hyrë në fuqi;

b) në rast të taksave të tjera, në lidhje me taksat e vendosura për periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik vijues, duke ndjekur atë në të cilin Marrëveshja ka hyrë në fuqi.

Neni 33
Përfundimi

Kjo Marrëveshje do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë kohore të pakufizuar, por secili nga shtetet kontraktuese, në ose para datës 30 qershor të çdo viti kalendarik që fillon pas skadimit të një periudhe prej pesë vjetësh nga data e hyrjes së saj në fuqi, mund ta njoftojë me shkrim shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet rrugëve diplomatike, në lidhje me zgjidhjen e Marrëveshjes dhe këtë rast kjo Marrëveshje do të pushojë që qeni në fuqi:

a) lidhur me taksat e mbajtura në burim: për shumat, të cilat paguhen në datën ose pas datës 1 janar të atij viti kalendarik, që vijon pas vitit të anulimit;

b) lidhur me taksat e tjera: për taksat, të cilat mblidhen për periudha prej datës 1 janar të atij viti kalendarik, që vijon pas vitit të anulimit.

Data e marrjes së këtij njoftimi nga shteti tjetër kontraktues do të jetë përfundimtare për përcaktimin e afatit kohor.

Bërë në Berlin, më 6 prill 2010 në dy origjinale, secili në gjuhën gjermane, shqipe dhe angleze, duke qene të tri tekstet autentike. Në rast mosmarrëveshjesh në interpretimin e teksteve në gjuhën gjermane dhe shqipe, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PROTOKOLL I MARRËVESHJES

NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TAKSAT MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN

të datës….

Republika e Shqipërisë dhe Republika Federale e Gjermanisë, në plotësim të marrëveshjes së.....për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe evazionit fiskal në lidhje me taksat mbi të ardhurat dhe kapitalin, kanë rënë dakord mbi dispozitat e mëposhtme, të cilat do të jenë pjesë përbërëse të Marrëveshjes së mësipërme:

1. Duke iu referuar nenit 7:

a) Kur një ndërmarrje e një shteti kontraktues shet mallra ose drejton biznesin në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një vendqëndrimi të përhershëm të ndodhur në të, fitimet e atij vendqëndrimi të përhershëm nuk do të përcaktohen mbi bazën e sasisë totale të marrë nga ndërmarrja, por vetëm mbi bazën e sasisë që i atribuohet aktivitetit aktual të vendqëndrimit të përhershëm për këto shitje ose këtë biznes.

b) Nëse një ndërmarrje ka një vendqëndrim në shtetin tjetër kontraktues, atëherë në rast kontratash, veçanërisht për projektimin, furnizimin, montimin ose ndërtimin e pajisjeve apo objekteve industriale, tregtare ose shkencore apo kontratash të punëve publike, fitimet e këtij vendqëndrimi nuk përcaktohen në bazë të shumës totale të kontratës, por vetëm në bazë të asaj pjese të kontratës, e cila zbatohet faktikisht nga vendqëndrimi në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet ai. Fitimet që rrjedhin nga furnizimi i mallrave për në vendqëndrimin në fjalë ose përfitimet në lidhje me atë pjesë të kontratës, e cila zbatohet në shtetin kontraktues, në të cilën ndodhet selia qendrore e ndërmarrjes, mund të tatohen vetëm në këtë shtet.

2. Duke iu referuar neneve 7, 12 dhe 14:

Pagesat e marra për shërbimet teknike, duke përfshirë studimet ose vëzhgimet e një natyre shkencore, gjeologjike ose teknike apo për kontratat inxhinierike që përfshijnë skica (blue prints) në lidhje me këtë ose për shërbime konsulence apo mbikëqyrjeje, nuk do të konsiderohen tarifa për të drejtat e autorit sipas nenit 12, por sipas rastit, do të çmohen të jenë pagesa ndaj të cilave do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose 14 të marrëveshjes.

3. Duke iu referuar nenit 10:

Termi “dividendë” do të përfshijë gjithashtu shpërndarjet rreth aksioneve në një fond investimi ose trust investimi.

4. Duke iu referuar neneve 10 dhe 11:

Pavarësisht nga dispozitat e nenit 10 dhe 11 të kësaj Marrëveshjeje, dividendët dhe interesat mund të tatohen në shtetet kontraktues në të cilin ato lindin dhe sipas ligjit të atij shteti, nëse ato:

a) bazohen mbi të drejtat ose kërkesat lidhur me të drejtën për të marrë pjesë në fitim,

duke përfshirë të ardhurat e një partneri të heshtur (stiller Gesellschafter) nga pjesëmarrja e tij si partnerë i heshtur, ose të ardhurat nga huatë me pjesëmarrje në fitim (partiarisches Darlehen/profit participating loan) ose nga pretendimet për fitime të lidhura me dividentë (Gewinnobligationen), në kuptimin e legjislacionit fiskal gjerman, dhe

b) me kusht që ato jenë të zbritshme në përcaktimin e fitimeve të debitorit të këtyre të ardhurave.

5. Duke iu referuar nenit 15:

Dispozitat e paragrafit 2 të nenit 15 nuk do të gjejnë zbatim për pagesat e kryera në funksion të punësimit të përkohshëm të punëmarrësve.

6. Duke iu referuar nenit 26:

Në rast se në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe në bazë të kësaj Marrëveshjeje përcillen të dhëna personale, vlejnë si plotësim dispozitat e mëposhtme, duke respektuar dispozitat ligjore që janë në fuqi në secilin shtet kontraktues:

a) Përdorimi i të dhënave nga institucioni marrës lejohet vetëm për qëllimin e deklaruar dhe vetëm në kushtet e përcaktuara nga institucioni përcjellës;

b) Institucioni marrës e informon institucionin përcjellës, me kërkesën e këtij të fundit, për përdorimin e të dhënave të komunikuara dhe për rezultatet e fituara nga kjo.

c) Të dhëna personale mund t'u përcillen vetëm autoriteteve kompetente. Përcjellja e tyre e mëtejshme për në institucione të tjera mund të bëhet vetëm me miratim paraprak të institucionit përcjellës.

d) Institucioni përcjellës është i detyruar të sigurojë korrektësinë e të dhënave të komunikuara dhe të respektojë domosdoshmërinë dhe masën e tyre sipas qëllimit të përcjelljes, duke mbajtur paraysh dispozitat ndaluese të përcjelljes së të dhënave sipas legjislacionit të brendshëm të secilit shtet. Nëse vërtetohet se janë përcjellë të dhëna të gabuara ose të dhëna që nuk duheshin përcjellë, atëherë një gjë e tillë i duhet bërë e ditur menjëherë institucionit marrës. Ai është i detyruar të bëjë pa vonesë korrigjimin ose fshirjen e të dhënave në fjalë.

e) Personi i implikuar duhet të informohet me kërkesë të tij për të dhënat e përcjella, që kanë të bëjnë me të, si dhe për përdorimin e parashikuar të këtyre të dhënave. Nuk ka detyrim për dhënien e këtij informacioni, nëse nga analiza përkatëse del se interesi publik për të mos dhënë këtë informacion ka më shumë rëndësi se sa interesi i personit të implikuar për të marrë informacionin në fjalë. Përveç kësaj, e drejta e personit të implikuar të marrë informacion për të dhënat ekzistuese që kanë të bëjnë me të, varet nga legjislacioni i brendshëm i shtetit kontraktues, në territorin sovran të të cilit kërkohet informacion në fjalë.

f) Nëse një personi i shkaktohen dëme të paligjshme si pasojë e komunikimeve në kuadër të shkëmbimit të të dhënave sipas kësaj Marrëveshjeje, atëherë institucioni marrës do të përgjigjet për këtë në bazë të legjislacionit të tij të brendshëm. Në marrëdhënien e tij me personin e dëmtuar, institucioni marrës – me qëllim që të shkarkojë përgjegjësitë e veta – nuk mund të deklarojë se dëmi është shkaktuar nga shteti përcjellës.

g) Kur legjislacioni i brendshëm, që vlen për institucionin komunikues, parasheh rregulla të veçanta për fshirjen e të dhënave personale të përcjella, institucioni përcjellës e informon përkatësisht institucionin marrës. Pavarësisht nga ky ligj, të dhënat personale të përcjella duhen të fshihen sapo të rezultojë se nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë komunikuar.

h) Institucioni përcjellës dhe institucioni marrës janë të detyruar të dokumentojnë në dosjet e tyre përcjelljen dhe marrjen e të dhënave personale.

i) Institucioni përcjellës dhe institucioni marrës janë të detyruar të mbrojnë të dhënat personale të përcjella në mënyrë të efektshme kundër përhapjes, modifikimit dhe zbulimit të paautorizuar.